

LISTA E PËRJASHTIMEVE LIDHUR ME ÇËSHTJET EKOLOGJIKE DHE SOCIALE

Asnjë Hua individuale ose Nën Hua ose pjesë e tyre nuk do të përdoret për financimin e:

1. Prodhimin ose veprimtari që përfshijnë forma të rrezikshme ose eksploative të punës me forcë ⁽¹⁾/ praktikë diskriminuese të punës së rrezikshme të fëmijëve ⁽²⁾ ose praktika që ndalojnë të punësuarit që ligjërisht ti realizojnë të drejtat e tyre të bashkimit dhe tregtimit kolektiv ⁽³⁾.
2. Prodhimit ose tregtimit të produkteve ose aktiviteteve që llogariten ilegale sipas ligjeve dhe akteve të vendit nikoqir ose konventave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare.
3. Prodhimin dhe tregtimin me armë dhe municion ⁽⁴⁾.
4. Prodhimin ose tregtimin me pije alkoolike (pa birrë dhe verë) ⁽⁴⁾.
5. Prodhimin dhe tregtimin me duhan ⁽⁴⁾.
6. Bixhozin, kazinotë dhe shoqatat e ngjashme ⁽⁴⁾.
7. Tregtimin me produkte nga natyra e egër të rregulluara sipas CITES ⁽⁵⁾.
8. Prodhimin ose tregtimin me materiale radioaktive ⁽⁶⁾.
9. Prodhimin ose tregtimin ose shfrytëzimin e fijeve të palidhura të asbestit ⁽⁷⁾.
10. Prodhimin ose tregtimin me drunjë dhe produkte të tjera pyllore nga pyje të pamenaxhuara ⁽⁷⁾.
11. Prodhimin ose tregtimin me produkte që përmbajnë PSV ⁽⁸⁾.
12. Prodhimin, tregtimin, magazinimin ose transportin e sasive të konsiderueshme të kemikalieve të rrezikshme ose përdorim komercial të kemikalieve të rrezikshme ⁽⁹⁾.
13. Prodhimin ose tregtimin me produkte farmaceutike të cilët ndërkombëtarisht janë të ndaluara ⁽¹⁰⁾.
14. Prodhimin ose tregtimin me pesticide/hibricide të cilat ndërkombëtarisht janë të ndaluara ⁽¹¹⁾.
15. Prodhimin ose tregtimin me substanca të rrezikshme që ndërkombëtarisht janë të ndaluara ⁽¹²⁾.
16. Peshkimin me rrjeta me gjatësi më të madhe se 2,5 km në rajonet e limaneve;
17. Veprimtarive të ndaluara nga legjislacioni i vendit nikoqir ose konventave ndërkombëtare që kanë të bëjnë me mbrojtjen e biodiversitetit dhe llojshmërisë kulturore ⁽¹³⁾.
18. Dërgimin e naftës ose materieve të tjera të rrezikshme në tankierë të cilët nuk janë të adaptuar me standardet IMO ⁽¹⁴⁾.
19. Tregtimin me mallra pa licencat e nevojshme për eksport ose import ose argumente për tranzit të autorizuar nga vendet e importit, eksportit dhe nëse është e realizueshme, tranzit.
20. Bankingun, sigurimet dhe ndërmjetësimin financiar ⁽¹⁵⁾.
21. Aktivitete komerciale të prerjes ose blerjes së pajisjeve për prerje për shfrytëzim në pyjet primare ose rajonet pyjore me vlerë të biodiversitetit, as edhe aktivitete të tjera që ndikojnë në prerjen e pyjeve të tilla.

-
1. Punë me forcë nënkupton puna ose shërbimi që nuk kryhet vullnetarisht, por që kërcënohet nga personi, nën kanosjen e forcës ose dënimit.
 2. Punë me forcë e fëmijëve nënkupton punësimin e fëmijëve për shkak të eksplotimit ekonomik dhe e cila punë mund të jetë e rrezikshme dhe mund ta frenojë arsimin e fëmijut, mund të jetë e rrezikshme dhe keq të ndikojë mbi shëndetin e fëmijut ose mbi zhvillimin e tij fizik, mental, shpirtëror ose social.
 3. Dokumente referimi janë deklaratat e ILO për parimet dhe të drejtat fundamentale të vendit të punës, respektivisht ato të përfshira në këto konventa: Konventat e ILO 29 dhe 105 (puna me forcë dhe robëria), 87 (liria e bashkimit), 98 9 e drejta e tregtimit kolaborativ), 100 dhe 111 (diskriminimi), 138 (mosha minimale), 182 (format më të këqija të punës së fëmijëve) Deklarata universale e të drejtave të njeriut
 4. Kjo nuk zbatohet për sponzorë të nën projekteve të cilët nuk janë të përfshirë në mënyrë të konsiderueshme në këto

aktivitete. “Nuk janë të përfshirë në mënyrë të konsiderueshme“ nënkupton se aktivitetet përkatëse janë dytësore në raport me punën kryesore të sponsorit të nën projektit.

5. CITES: Konventa për tregti ndërkombëtare me lloje të rrezikuara ose botë të egër shtazore dhe bimore..
6. Llojet e përmendura në CITES mund të gjenden për shembull te Departamenti për mjedis jetësore te IFC.
7. Kjo nuk ka të bëjë me blerjen dhe shfrytëzimin e pllakave të doganuara nga çimentoja e asbestit ku përmbajtja e asbestit është më pak se 30 përqind.
8. PSVs: bifenilet poliklorinate – grup i kemikalieve shumë toksike. Më shpesh gjenden tek transformatorët elektrik të mbushur me naftë, kondenzatorë dhe ndërprerës që datojnë nga vitet 1950 – 1985.
9. Lista e materialeve të rrezikshme mund të gjendet për shembull te Departamenti për mjedis jetësor i IFC. Materiet e rrezikshme përfshijnë benzinë, kerozinë dhe produkte të tjera të naftës. Dokumente plotësuese referimi janë: Rregullativa e BE-së (EEC) nr. 2455/92 për import dhe eksport të kemikalieve të caktuara të rrezikshme, me ndryshimet dhe plotësimet përkatëse; Lista e konsoliduar e produkteve konsumi/shitja e të cilëve është e ndaluar, tërhequr, rreptësisht e kufizuar ose nuk është e aprovuar nga Qeveritë, e përgatitur nga KB-ja; Konventa e procedurave për informim paraprak për disa kimikalie të rrezikshme dhe pesticide në tregtimin ndërkombëtar (Konventa e Roterdamit); Konventa e Stokholmit për ndotësit organik; Klasifikimi i Organizatës botërore të shëndetësisë për pesticidet e rrezikshme.
10. Lista e produkteve farmaceutike që janë të ndaluara, në dispozicion nga Departamenti për mjedis jetësor i IFC
11. Lista e pesticideve dhe herbicideve që janë të ndaluara, në dispozicion nga Departamenti për mjedis jetësor i IFC
12. Përbërës që dëmtojnë ozonin: Komponente kimike që ndikojnë dhe dëmtojnë ozonin stratosferik, me çka rezultojnë në krijimin e vrimave të mëdha të ozonit. Protokollin e Montreallit jep listën e përbërësve të tillë dhe datat e reduktimit dhe ndalimit të tyre qëllimor. Lista e përbërësve kimik e rregulluar me Protokollin e Montreallit përfshijnë aerosolet, antipiretikët, agjensët që shkaktojnë shkumë, tretës, agjensë për mbrojtje nga zjarri, bashkë me të gjitha detajet dhe shtetet nënshkruese dhe datat e ndalimit të tyre, në dispozicion nga Departamenti për mjedis jetësor i IFC
13. Konventat relevante ndërkombëtare që pa parjashtim përfshijnë:Konventën për mbrojtjen e specieve shtegtare të shtazëve të egra (Konventa e Bonit); Konventa për moçalet me rëndësi ndërkombëtare, veçanërisht si vendbanime të zogjve të ujit (Konventa e Ramsarit); Konventa për mbrojtjen e shtazëve të egra evropianë dhe vendbanimet natyrorë (Konventa e Bernit); Konventa për trashëgimi botërore; Konventa për llojllojshmëri biologjike
14. Kjo përfshin: rezervoare që nuk kanë të gjithë liçencat e nevojshme MARPOL dhe SOLAS (përfshirë, pa kufizime, përputhshmëri me kodin ISM), rezervoare që janë në listat e zeza të Bashkimit Europian, ose janë të ndaluara me memorandumun e Parisit për mirëkuptim për kontroll shtetëror limanor (Paris MOU), dhe rezervoare që janë përjashtuar në kuadër të rregullativave 13G dhe 13H nga Aneksi I i MARPOL. Nuk duhet të përdoret asnjë tanker më i vjetër se 25 vjet..
15. Sipas Rekomandimit të Komisionit Evropian nga 6 maji 2003 (OJ L 124; 20/05/2003, fq. 36)

“Konsiderueshëm “ ka të bëjë me shkallën e shkatërrimit të pyjeve i cili sjell deri te humbja e funksioneve bazike të pyjeve, nëpërmjet reduktimit të hapësirave nën minimumin kritik. “Funksionet bazike “ janë të definuara si: aftësi për biodiversitet, menaxhim me rajone ujore, kontroll të erozionit dhe shpërnguljen e autoktonëve/vendasve